



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development
Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/Agencija za Razvoj Poloprivrede/ Agriculture Development Agency

THIRRJE PËR APLIKIM

PËR GRUPET LOKALE TË VEPRIMIT TË PËRZGJEDHURA DHE PËR RRJETIN PËR ZHVILLIM RURAL TË GLV-VE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

PËR PËRFITIM NË KUADËR TË IMPLEMENTIMIT TË “PLANIT PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL 2014-2020”, MASA 303.2, “ZBATIMI I STRATEGJIVE ZHVILLIMORE LOKALE” Aktiviteti i parë - “ FUNKSIONALIZIMI I GLV-VE TË PËRZGJEDHURA dhe RRZHR DUKE MBESHTET SHPENZIMET OPERATIVE TE TYRE ”

Qëllimi i thirrjes për aplikim

Qëllimi i thirrjes për aplikim është funksionalizimi i GLV-ve të përzgjedhura duke i mbështetur shpenzimet operative të tyre .Ky aktivitet do të kontribuoj në arritjen e objektivave të PBZHR 2014 – 2020 të GLV-ve të përzgjedhura me qëllim të funksionalizimit të tyre. Qëllimi i aktiviteteve të parapara është përkrahja e ngritjes së kapaciteteve të GLV-ve të përzgjedhura, anëtarëve të GLV-ve dhe banorëve rural me qëllim të rritjes së shkathtësive të tyre në fushën e demokracisë dhe zhvillimit lokal, si dhe të inkurajimit të tyre në avancimin e nismave dhe partneriteteve lokale. Për më tepër, që të lehtësohet ndërveprimi mes palëve me interes me qëllim të ofrimit të informatave dhe të avancimit të strategjisë e të përkrahjes së përfituesve të mundshëm në zhvillimin e punëve dhe në përgatitjen e aplikacioneve. Po kështu, GLV-të do të jenë në gjendje të kenë strukturë dhe staf të përhershëm.

Përfituesit e pranueshëm

Përfituesit përfundimtar të Masës 303 me nënmasën 303.2 „ Zbatimi i strategjive zhvillimore lokale - Qasja Leader, janë të gjitha GLV- të e përzgjedhura dhe Rrjeti i Zhvillimit Rural të GLV-ve.

Shtrirja gjeografike

GLV-të e përzgjedhura mbulojnë 12 komunat përkatëse të Kosoves në të cilat ato funksionojnë.

Investimet e pranueshme për GLV- të potenciale dhe RrZhr të GLV-ve.

Shpenzimet për hapjen e zyres/funksionalizimin e GLV-ve të përzgjedhura, gjegjësisht shpenzimet operative .

Lista e dokumenteve të dorëzuara

Për GLV-të e përzgjedhura

1. Formularin për Aplikim - sipas modelit të AZHB-së preferohet të jetë i plotësuar me makinë ose kompjuter.	<input type="checkbox"/>
2. Projekt propozimi	<input type="checkbox"/>
3. Lista e anëtarëve të trupit menaxhues i cili ka këtë përbërje: - së paku 50% partnerët ekonomik, shoqëria civile, shoqata e tj., - së paku 20% nga institucionet publike - së paku 10% te gjinisë femërore ose të rinjë (nën 40 vjet) (Në listë të anëtarëve të paraqitet data e lindjes dhe gjinia)	<input type="checkbox"/>
4. Certifikatën e regjistrimit të GLV-së së përzgjedhur në Regjistrin e OJQ-ve, në Ministrinë e Administratës Publike.	<input type="checkbox"/>
5. Kopje e letër njoftimit të përfaqësuesit të autorizuar nga GLV-ja e përzgjedhur.	<input type="checkbox"/>
6. Dëshminë e xhirollogarisë bankare në emër të përfaqësuesit të GLV-së së përzgjedhur.	<input type="checkbox"/>
7. Certifikatën e numrit fiskal të GLV-së së përzgjedhur.	<input type="checkbox"/>

Për RRZHR-në

1. Formularin për Aplikim - sipas modelit të AZHB-së preferohet të jetë i plotësuar me makinë ose kompjuter.	<input type="checkbox"/>
2. Projekt propozimi	<input type="checkbox"/>
3. Dëshminë se menaxheri (udhëheqësi i RrZhr-së) ka eksperiencë në zhvillim rural/ Diploma e fakultetit dhe CV-ja	
4. Certifikatën e regjistrimit të RRZHR-së në Regjistrin e OJQ-ve, në Ministrinë e Administratës Publike.	<input type="checkbox"/>
5. Kopje e letër njoftimit të përfaqësuesit të autorizuar nga RRZHR-ja.	<input type="checkbox"/>
6. Dëshminë e xhirollogarisë bankare në emër të përfaqësuesit të RRZHR-së.	<input type="checkbox"/>
7. Certifikatën e numrit fiskal të RRZHR-së.	<input type="checkbox"/>
8. Dëshmia e kryerjes së obligimeve të anëtarësisë ndaj RRZHR-së.	<input type="checkbox"/>

Shkalla e përkrahjes

Shkalla e përkrahjes për aktivitetin e parë “Funksionalizimi i GLV–ve të përzgjedhura” është 100%.

Data e fillimit për aplikim është dita pasi të jetë e publikuar thirrja për aplikim **14.04.2017 deri më 28.04.2017**

Afati për aplikim është 15 ditë nga data e publikimit.

Aplikacionet duhet të jenë të kompletuara

Në rast të mungesës së ndonjë dokumenti obligativ, zyrtari i Agjencionit për Zhvillimin e Bujqësisë nuk e pranon aplikacionin. Aplikanti ka afat deri në përfundim të thirrjes për aplikim që të kompletoj dokumentet.

Nëse nuk plotësohen këto kushte brenda afatit të paraparë, projekti refuzohet.

Aplikacionet e kompletuara dorëzohen në Zyret e Agjencionit për Zhvillimin e Bujqësisë Rr:Migjeni (ish Banka e Lublanës kati 7). 10 000 Prishtinë , çdo ditë pune, nga ora 10:00 -12:00 dhe 13:00 – 15:00

Për informata më të hollësishme vizitoni web faqen: www.azhb.rks-gov.net dhe www.mbpzhr-gov.net, si dhe udhëzuesin për aplikues.